

VENDIM
Nr. 47, datë 27.2.2025

**MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË
METODOLOGJINË E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI
I ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nën pikës 3.5 të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 3, pika 8, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO)”, si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe të Kosovës”, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a., dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.2.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1191 prot., datë 25.2.2025 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ‘Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës’ dhe ‘Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë’”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 4536/4 prot., datë 31.10.2024, ka përcjellë për shqyrtim disa shtesa dhe ndryshime në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 27.5.2024, të Bordit të ERE-s, si dhe në “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”, miratuar me vendimin nr. 101, datë 27.5.2024, të Bordit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 250, datë 25.11.2024, vendosi: Fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Metodologjinë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni i Energjisë Elektrike Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”.

- Vendimi nr. 249/2024 u është komunikuar palëve të interesit me shkresën nr. 1899/4 prot., datë 27.11.2024. Gjithashtu, shtesat dhe ndryshimet e propozuara janë publikuar në seksionin “Konsultime” të faqes zyrtare të internetit të ERE-s dhe deri në këtë vendimarrje nuk kemi marrë asnjë koment nga ndonjë palë e interesuar.

- Ndryshimet e propozuara nga OST sh.a. synojnë përmirësimin e metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni, kryesisht duke zgjeruar fushën e zbatimit dhe përfshirjen e tregut brenda ditës, si më poshtë vijon:

- Në pikën 6 shtohet një paragraf që metodologjia CID mbulon, si tregun e ditës në avancë, ashtu edhe atë brenda ditës.

- Në pikën 8, përmendet specifikisht edhe tregu brenda ditës në përshkrimin e alokimit të kapaciteteve.

- Neni 1 (Qëllimi dhe objekti): Shtohet një germë e re e referuar si germa “d” për të sqaruar se metodologjia mbulon të ardhurat nga kongjestioni për tregun brenda ditës.

- Neni 3 (Përkufizimet dhe interpretimi): Shtohen referenca për tregun brenda ditës (AL-KS IDA) në përkufizimet ekzistuese.

- Neni 5 (Parimet për ndarjen): Për të ardhurat neto kufitare, shtohet qartësimi se ndarja 50%–50% vlen për të dyja tregjet (AL-KS DAC dhe AL-KS IDA).

- Këto ndryshime sigurojnë një qasje më të plotë për menaxhimin dhe shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni në të gjitha intervalet kohore të tregut.

- Vlerësojmë se shtesat dhe ndryshimet e propozuara nga OST sh.a. pasqyrojnë kërkesat e nevojshme për zbatueshmërinë e këtyre dokumenteve edhe në tregun e organizuar të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë. Këto ndryshime nuk cenojnë parimet e metodologjive në fuqi të miratuara nga ERE, por zgjerojnë fushën e tyre të veprimit, duke përfshirë edhe tregun brenda së njëjtës ditë të Bursës Shqiptare të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Metodologjinë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni i Energjisë Elektrike Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, si më poshtë vijon:

- Pika 6 ndryshon dhe bëhet: “OST-ja, KOSTT-i dhe NEMO-ja e Shqipërisë dhe e Kosovës përgatitën Metodologjinë për shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni (në tekstin e mëtejme referuar si (“Metodologjia CID”)). Metodologjia CID duhet të mbulojë shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni, si për periudhën e ditës në avancë, ashtu edhe brenda së njëjtës ditë.

- Pika 8 ndryshon dhe bëhet: Metodologjia CID është strukturuar në dy pjesë. Së pari, përcaktimi dhe mbledhja e të ardhurave të kongjestionit të krijuara nga alokimi implicit i kapaciteteve në bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë dhe tregut brenda ditës (në tekstin e mëtejme referuar si (“AL-KS DAC” dhe “AL-KS IDA”). Së dyti, shpërndarjen e të ardhurave të kongjestionit të mësipërm, ndërmjet OST-së dhe KOSTT-it.

- Pika 9 ndryshon dhe bëhet: Si përfundim, kjo metodologji CID e propozuar nga OST-të dhe NEMO-n e Shqipërisë dhe të Kosovës i paraqitet për miratim rregullatorëve përkatës, në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes Kornizë.

- Neni 1, pika 1, shtohet germa “d” me këtë përmbajtje: “d) Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve në harkun kohor brenda ditës.”

- Neni 3, pika 3, germa “b”, ndryshon dhe bëhet: “b) përveç nëse nuk specifikohet ndryshe, termat e përdorur zbatohen në kontekstin e bashkimi të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë (AL-KS DAC) dhe bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri–Kosovë (AL-KS IDA), si dhe (EMCS) për AL-KS DAC dhe AL-KS IDA.”

- Neni 5, pika 1, ndryshon dhe bëhet: “OST-ja dhe KOSTT-i do të marrin pjesën e tyre të të ardhurave neto kufitare AL-KS DAC dhe AL-KS IDA, bazuar në një koeficient ndarjeje 50% me 50%. Detajet, si dhe arsyet themeluese, përcaktohen në shtojcën 1 të kësaj metodologjie.”

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti